



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHEKRITEREVEPËRKUALIFIKIM**
(Kyprocesverbal ështëpërefektpublikimi bashkëmedokumentet etenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje dhe vendosje e kamerave”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31224400-6;

32421000-0;

38651600-9;

VLERA E FONDIT LIMIT: 23,747,071.66(njëzet e tre million e shtatëqind e dyzetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e një.66) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: "...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik..."

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e fondit limit:**

0,4x23,747,071.66=9,498,828.7 (nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzet e tetë.7) Lekë pa TVSH;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është percaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, indryshuar.

2.2.3 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit si dhe të shoqëruara me AktEkspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **11,878,536.8 (njëmbëdhjetë million e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë.8) lek pa TVSH** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **47,494,143.32 (dyzetë e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e dyzetë e tre mijë.32) lekë pa TVSH;**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën pëqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer).
 - Kontratë sipërmarrje;
 - Situacion përfundimtar;
 - Faturat tatimore për këtë situacion;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer).
 - Kontratë sipërmarrje;
 - Situacion përfundimtar;
 - Faturat tatimore për këtë situacion;
 - Akt kolaudimi objekti.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të

zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatorit ekonomik ofertues i është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE – së, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ushtron aktivitetin tregtar në fushën objekt prokurimi duke zbatuar normat e sistemit të menaxhimit të cilësisë. Për këtë kriter ofertuesi duhet të para:

- Certificate cilesie sipas standartit Standartit ISO 39001:2012 per sistemet e menaxhimit te sigurise rrugore ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit Standartit ISO 45001:2018 per Sistemet e Manaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne vendet e punes ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Certificate cilesie sipas standartit SSH ISO/IEC 20000-1:2018 Teknologji Informacioni - Menaxhimi i shërbimit - Pjesa 1: Kërkesat e sistemit të menaxhimit të shërbimit, ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- Certificate cilesie sipas standartit SSH EN ISO/IEC 27001:2017 Teknologjia e informacionit - Teknikat e sigurisë - Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit - Kërkesat (ISO / IEC 27001: 2013, duke përfshirë Cor 1: 2014 dhe Cor 2: 2015), ose ekuivalente me to, origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar në emër të ofertuesit nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë keto certifikata ne perputhje me zerat qe ka marre persiper te kryeje si dhe te jene aktive.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u nisur nga kërkesat e cilësisë së mallrave që do të furnizohen për të cilat duhet të jepet garanci, të jene brenda afateve të skadences, të jenë të ambalazuara, të mos jenë të mbushura etj. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Vendosija e ketyre certifikatave eshte kryer pas konsultimit dhe bazuar ne Katalogun e Standarteve Shqiptare per vitin 2021. Me konkretisht:

1. Certifikata ISO 39001:2012 për Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë Rrugore

Kjo certifikatë është thelbësore për të garantuar standardet më të larta të sigurisë rrugore për një projekt që kërkon instalime në rrugë publike. Përfshirja e ISO 39001 është e nevojshme për të garantuar që ofruesi të përputhet me standardet e sigurisë gjatë implementimit të një rrjeti survejimi rrugor.

Argumentim: Përdorimi i lidhjeve të qëndrueshme dhe të sigurta, si fibra optike (F.O.), është themelor për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit, veçanërisht në aspektin teknologjik dhe kibernetik. Puna kryesisht në rrugët e Bashkisë Vlorë kërkon që operatori ekonomik (OE) të përmbushë standardet e punës për të mbrojtur punonjësit, makineritë dhe përdoruesit e rrugëve.

2. Certifikata ISO 45001:2018 për Shëndetin dhe Sigurinë në Vendin e Punës

Kjo certifikatë kërkohet për të garantuar që stafi dhe proceset e punës civile do të kryhen në përputhje me standardet për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe sigurisë në punë.

Argumentim: Për shkak të natyrës së punimeve (gërmime, instalime në lartësi, mbulime), është e domosdoshme që OE të operojë sipas standardeve për shëndetin dhe sigurinë e

stafit, për të siguruar që procedurat për mbrojtjen e punonjësve të jenë në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

3. Çertifikata ISO 9001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë

Kjo certifikatë shërben si garanci për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Argumentim: Certifikata **ISO 9001:2015** është një standard ndërkombëtar që kërkohet për të siguruar që cilësia e mallrave dhe shërbimeve të jetë në përputhje me kërkesat e AK për një performancë të lartë dhe garanci cilësie.

Në kontekstin e kërkesave për certifikatat e cilësisë dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për projektin e sigurisë rrugore dhe mbikëqyrjes, janë përfshirë disa kërkesa thelbësore për certifikata ISO për të garantuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemeve të propozuara dhe procesit të instalimit të tyre.

4. Çertifikata ISO/IEC 20000-I:2018 për Teknologjinë e Informacionit dhe Menaxhimin e Shërbimeve

Kjo certifikatë është e nevojshme për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e pajisjeve dhe shërbimeve IT, si servera, kamera, dhe pajisje të tjera të përfshira në projekt.

Argumentim: Certifikata **ISO/IEC 20000-I:2018** siguron që OE është i aftë të menaxhojë dhe ofrojë shërbime IT të cilësisë së lartë, duke përfshirë konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, për të garantuar një performancë optimale dhe qëndrueshmëri për sistemin e menaxhimit të shërbimit.

5. Çertifikata ISO/IEC 27001:2017 për Sigurinë e Informacionit

Kjo certifikatë kërkohet për të garantuar mbrojtjen e informacionit dhe sigurinë kibernetike të sistemit të instaluar.

Argumentim: Problemet me sulmet kibernetike në vend dhe në botë kërkojnë që AK të garantojë sigurinë e sistemeve. Certifikimi ISO/IEC 27001:2017, ose ekuivalenti, siguron që OE të ketë sisteme mbrojtëse dhe masa të nevojshme për mbrojtjen e të dhënave dhe të sigurisë kibernetike. Këto certifikata janë të domosdoshme për të siguruar që projekti të përmbushë standardet ndërkombëtare për cilësi, siguri dhe menaxhim të shërbimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit për furnizimin e listës së artikujve sipas tabelës. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të percaktojë periudhën e vlefshmerisë së tij.

Përshkrimi i Produkteve

- Server Video Regjistrator Rrjeti NVR/Server minimumi 128 Kanale
- Kamera te jashtme Survejimi
- Kamera LPR e Levizeshme
- Kamera LPR bullet
- Kamera e Dedikuar Trafiku
- Software Menaxhimi WMS
- Switch Industrial 8 Port PoE
- Switch Fiber Optike L3
- Kuti Metalike per CCTV e kompletuar
- UPS 10Kva Rack mounted perfshire
- Monitor Industrial per Video Wall 55"
- Controller per Video Wall

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin 40, pika 5/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë prodhues ose kanë mundësinë të marrin artikujt e ofruar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Gjithashtu nëpërmjet këtij kriteri operatorët ekonomikë dëshmojnë se ofrojnë një produkt cilësor në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Ky kriter është i gërshetuar edhe me kriteret e tjera të kësaj procedure për furnizimin me mallra cilësore që do të shërbejnë për rritjen e sigurisë publike.

Autorizimi i prodhuesit është nje dokument i rëndësishëm, pasi përvecse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, sidhe personelin e nevojshëm, gjithçkanë funksionet e realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën sipas pikës 2.3.3, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dorëzojnë ose fragmente të katalogut/ëve prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi për të treguar se janë në përputhje me specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të produkteve sipas listës së mëposhtme:

Përshkrimi i Produkteve

- Server Video Regjistrator Rrjeti NVR/Server minimumi 128 Kanale
- Kamera të jashtme Survejimi
- Kamera LPR e Levizeshme
- Kamera LPR bullet
- Kamera e Dedikuar Trafiku

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku*

përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Nga Autoriteti Kontraktor janë përzgjedhur që të kërkohen mostra për ato mallra që kanë konsum/përdorim më të përgjithshëm, që kanë premisa të dëmtohen/digjen më shpejt dhe që nevoja për të është në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme. Gjithashtu këto mostra kërkohen për të verifikuar kompatibilitetin e tyre me sistemin aktual që përdor DVPV.

2.3.6 Operatori ekonomik do të paraqesë një deklaratë të garancisë me afat 1 vit për pajisjet objekt të kësaj procedure prokurimi.

Shënim: (Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 do të konsiderohet I përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit dhe dokumentacioni provues do të paraqitet nga operatori ekonomik I kualifikuar në vend të parë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, 40, pika 8.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe zërave të preventivit objekt i kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik do të paraqesë një deklaratë që pas kryerjes së instalimit të pajisjeve dhe konfigurimit të tyre, do të riparojë defektet e mundshme gjatë periudhës së garancisë brenda afateve të përcaktuara në kontratë, si dhe merr përsipër të realizojë të paktën 5 seanca trajnimi të ndryshme me stafin që do të përdorë pajisjet objekt të kësaj procedure prokurimi.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, 40, pika 8.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe zërave të preventivit objekt i kontratës.

2.3.8 Duke patur parasysh produktet, shërbimet dhe konfigurimet që duhet të kryhen në kohë dhe me cilësi për këtë procedure si dhe në funksion të realizimit të pikës 2.3.7 dhe 2.3.8, Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht stafin e mëposhtem të nevojshëm në minimumi 3 muajt e fundit që duhet të jetë i përbërë të paktën nga:

Minimumi 1 (një) inxhinier elektronik/kompjuterik.

Minimumi 1 (një) inxhinier informatike

Minimumi 1 (një) inxhinier telekomunikacioni

Minimumi 1 (një) inxhinier elektrik prej të cilëve të paktën 1 (një) të specializuar për automatizim dhe të licensuar sipas kategorive profesionale për projektet e linjave të rrjeteve elektrike dhe sinjalistikes.

Minimumi 1 (një) inxhinier ndertimi specializuar për infrastrukture për ndjekjen e punimeve civile të nevojshme për shtrimin e rrjetit fiber optike të licensuar sipas kategorive profesionale për projektet në rruget lokale, urbane dhe interurbane duke përfshirë dhe sinjalistikën.

Minimumi 2 (dy) teknike instalimesh të telekomunikacionit.

Minimumi 2 (dy) persona të certifikuar nga Prodhuesit e Pajisjeve për instalimin e produkteve CCTV, Video Wall & Controller, UPS dhe mirëmbajtjen e tyre.

Minimumi 1 person të certifikuar sipas standartit ndërkombëtar CCNA ose ekuivalente.

Minimumi 1 person të certifikuar sipas standartit ndërkombëtar CCNA Security OSE EKUIVALENTE.

Minimumi 1 person te certifikuar sipas standartit nderkombetar CCNP Enterprise OSE EKUIVALENTE.

Minimumi 1 person te certifikuar sipas standartit nderkombetar CCNA Routing & Switching OSE EKUIVALENTE.

të cilët të figurojnë me këtë kategori profesioni në listëpagesat e shoqërisë, si dhe të paraqiten:

- Kontrata Individuale pune (të vlefshme)
- Diploma e arsimit të lartë
- Certifikatat perkatese sipas kerkese te vlefshme

Kriteri 2.3.8 do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST dhe bazuar ne përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

Argumentim

Instalimi/konfigurimi/mirembajtja e ketij sistemi ndahet ne disa aspekte teknike ku jane te nevojshem specialistet ne fushat perkatese si me poshte te shpjeguara:

Installimet e rrjetit F.O , Splicimet, Ngjitjet, Lidhjet SFP, kerkojne inxhinier te posacem te cilet normalisht jane pjese e fushes se Telekomunikacionit. Eshte kerkuar minimalisht 1 person per kryerjen e ketij procesi.

Pajisjet Elektronike si Switche, Server, Kamera etj. kerkojne inxhinier te posacem te cilet normalisht jane pjese e fushes se Elektronike/Kompjuterike. Duke patur parasysh shtrirjen gjeografike, numrin e pajisjeve dhe kohen ne dispozicion numri 1 eshte minimumi i nevojshem per te siguruar ecurine e procesit dhe per te garantuar barazine e pjesemarrjes ne procedure.

Pjese e kesaj procedure jane dhe programet Software, Konfigurimet e tyre dhe mirembajtja e vazhdueshme. Kjo kerkon inxhinier te posacem te cilet normalisht jane pjese e fushes Informatike. Duke patur parasysh shtrirjen gjeografike, numrin e pajisjeve dhe kohen ne dispozicion numri 1 eshte minimumi i nevojshem per te siguruar ecurine e procesit dhe per te garantuar barazine e pjesemarrjes ne procedure.

Pajisja regjistruese Server do te instalohet dhe do te regjistroje imazhet ne ambientet e salles se monitorimit te DVPV e cila do te lidhet ne te njejtin rrjet F.O.

Pajisjet me te cilat do te lidhet ky sistem prane DVPV jane te markes Cisco i cili eshte nje brand i njohur nderkombetarisht si me i perdoruri ne vendin tone per sisteme te larta informatike dhe sigurie. Per kete arsye per te siguruar kryerjen me sukses te ketij procesi kerkohen Certifikimet CCNA, CCNA, CCNP Enterprise,

CCNA Routing & Switching, por per te mundesuar barazine ne tender dhe konkurrencen AK do te pranoje dhe Certifikime Ekuivalente te njohura nga ky brand. Theksojme se keto certifikime mund te jene te mbajtura dhe nga nje punonjes i kompanise OE.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.9 Nje punësim mesatar për tre muajt e fundit, i të paktën 20 (njëzetë) personave të vërtetuar me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listepagesa e deklaruar dhe e miratuar ne institucionet tatimore per 3 muajt e fundit.

Shënim: pjesë e punësimit është dhe stafi drejtues I pikës 2.3.8

Argumentim: Pjese e kesaj procedure eshte dhe ofrimi i sherbimit, mirembajtja e vazhdueshme e sistemit per te siguruar punen optimale te tij ne te gjithë shtrirjen gjeografike te Bashkise Vlore per 12 muaj 24H/7D. OE duhet te kete stafin e nevojshem per te siguruar ne cdo kohe suportin e nevojshem Teknik ne terren ose qender monitorimi ku perfshihet pjesa Elektrike, Telekomunikacion, IT.

Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.10 Duke patur parasysh instalimet e nevojshme dhe punimet civile qe duhen kryer per to me cilesi dhe ne kohe per kete procedure, Operatori ekonomik duhet te disponoje licensat profesionale sipas punimeve te parashikuara per realizimin e kesaj procedure si me poshte:

1. NP-1 Punime Germimi ne Toke
2. NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
3. NS-14 Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV, etj
4. Autorizim nga Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare per Shtrimet e Rrjeteve Fiber Optike dhe Ofrimin e Sherbime te Komunikimeve Elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.8, 2.3.9, 2.3.10 janë të gershetuara me njera tjetren dhe vijne bazuar ne në nenin 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në liçencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Nga autoriteti kontraktor, ne baze te marreveshjeve te bashkepunimit, eshte vendosur qe artikujt objekt te kesaj procedure prokurimi te iplementohen me sistemin aktual qe disponon Bashkia Vlore dhe te Drejtorise Vendore te Policise Vlore, ne kuader te rritjes te sigurise ne territorin e saj nepërmjet metodave të avancuara të raportimit dhe monitorimit të përshtatshem, duke siguruar funksionimin efektiv të bizneseve të kësaj bashkie dhe siguri maksimale për qytetarët e vet. Bazuar në nevojat e punës dhe takimet midis specialistëve të Bashkisë dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlore, janë përcaktuar pajisjet që janë të nevojshme të prokurohen, janë hartuar specifikimet teknike dhe preventivi me artikujt perkates. Vendosja e ketyre kriterëve te kualifikimit, eshte pjese e domosdoshme ne funksion te realizimit me sukses te kontrates, pasi pajisjet do te montohen, implementohen ne sistemet ekzistuese, do te provohen nese i kryejne funksionet sipas specifikimeve teknike, do te instalohen aplikacionet apo softëret perkatese etj. Kjo e ben te domosdoshem qe operatori ekonomik te jape nje garanci nje vjecare per pajisjet, por pervec sa me lart, me specialistet qe disponon do te ofroje trajnimet e nevojshme. Kerkesat dhe specializimet e stafit qe kerkohen jane te lidhura ngushte me natyren e kontrates qe prokurohet.

2.3.11 Produktet e survejimit duhet te jene te pajisura me Certifikate konformiteti (CE), sipas standarteve te miratuara si dhe nuk duhet te kene ndalim perdorimi neper Institucionet Shteterore ne asnje nga vendet partnere te Republikese se Shqiperise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në rast se pajisjet janë të pajisura me certifikate konformiteti (CE), sipas standarteve të miratuara, kjo është një garanci për cilësinë e tyre që tregon se janë të testuara nga institucionet e autorizuar, përpara hedhjes së tyre në treg.

Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimum mjetet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësi a	Sasia
1	Kamionçine (me kapacitet mbajtes nga 0.5 deri 3 ton)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
2	Eskavator me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
3	Mjete transporti stafi 4+1	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	3
4	Pajisje për ngjitje Fiber	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
5	Prerese Asfalti	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet :
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Liçencë transporti;
 - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
 - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:
 - a) Kontrata e qerasë
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

- c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);
 - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
 - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)
 - Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
 - Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.
 - Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
 - Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.
- Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin"*.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim për të provuar kapacitetet teknike të OE të cilat do të angazhohen në plotësimin e kushteve të kontratës sipas preventivit dhe specifikimeve teknike, në afatin e kërkuar, si dhe në përputhje me detyrimet ligjore të lejuara të lëvizjeve

të mjeteve të rënda. M.q.s instalimi i rrjetit të fibres optike totalisht të pavarur nga rrjete egzistuese ka nevojë për punime civile si hapje kanalesh dhe evadim dherash si dhe ngritjen e shtyllave me vinc minimumi i percaktuar 1 mjet për secilin është i nevojshëm për kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij projekti. Për të mundësuar konkurrencën dhe barazinë në procedurë është percaktuar: 'Në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi' për të mundësuar dhe OE që nuk i kanë në pronësi këto mjete të konkurrojnë në këtë procedurë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj"

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 29.11.2024